

SHTOJCE NR. 1

“Për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit, “Procedurë e hapur” me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Akademinë e Sigurisë”, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Në zbatim të nenit 42, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe nenit 62 të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, nëpërmjet marrëveshjes kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjes kuadër 3 (tre) vite me objekt **“Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Akademinë e Sigurisë”** dhe me fond total të marrëveshjes kuadër në vlerën prej 170,196,959 (njëqind e shtatëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, hartoi këtë shtojcë për ndryshime të dokumenteve të tenderit, si më poshtë:

Në dokumentet e tenderit, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Tek Shtojca 12 “Termet e referencës” tek IV. Kerkesat higjeno-sanitare:

Tek pika 4, nënpika e parë:

ISHTE:

- Te sigurojë një vend për larjen e duarve me ujë të ngrohtë, të ftohtë dhe për tharjen e tyre.

BËHET:

- Te sigurojë një vend për larjen e duarve me ujë të ngrohtë, të ftohtë dhe për tharjen e tyre për stafin e shërbimit.

Tek pika 4, nënpika e dytë:

ISHTE:

- Të vendosë në ambientet e mensës, aparate të filtrimit dhe ftohjes së ujit si dhe gota, në mënyrë që personat që trajtohen me ushqim të marrin e konsumojnë sasinë e nevojshme të ujit.

HIQET.

Në zbatim të pikës 2/1 të nenit 42 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, (i ndryshuar), për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, nëpërmjet marrëveshjes kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjes kuadër 3 (tre) vite me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Akademinë e Sigurisë”, afati kohor për dorëzimin e ofertave, shtyhet për në datën 21.01.2019 ora 11:00.

Hapja e ofertave do të bëhet në faqen zyrtare të internetit www.app.gov.al, si dhe pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë.